REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 845/20
Datë/Datum. 24.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 845/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenkovic – Anëtar , duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Grami"-SH.P.K-Prishtinë , kundër njoftimit për kontratë të aktivitetit kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me gëlqere të Hidratizuar", me nr. të prok: 020-KEK-20-4358-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Korporata Energjetike e Kosovës"SH.A , më datën: 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET , si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Grami"-SH.P.K-Prishtinë , kundër njoftimit për kontratë të aktivitetit kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me gëlqere të Hidratizuar", me nr. të prok: 020-KEK-20-4358-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Korporata Energjetike e Kosovës"SH.A.

II. ANULOHET, njoftimi për kontratë i autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me gëlqere të Hidratizuar", me nr. të prok: 020-KEK-20-4358-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Korporata Energjetike e Kosovës"SH.A .

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Grami"-SH.P.K-Prishtinë , i hudhet si e pa bazuar , i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: "Grami"-SH.P.K-Prishtinë , si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 23.10.2020 me nr. 845/20 , kundër njoftimit për kontratë të aktivitetit kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me gëlqere të Hidratizuar", me nr. të prok: 020-KEK-20-4358-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Korporata Energjetike e Kosovës"SH.A , duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 9 , 16 , 66 , si dhe nenin 60 të LPP-së,

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 05.11.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin ankimor se është shkelur Nenit 1.

Qëllimi te LPP për shkeljet e supozuara ne AK-ne këtë rast nuk qëndrojë për piken 1 te ankesës shkeljet e -se ky nen thekson :"Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase,më transparent edhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të

autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen,procedurat që do të ndiqen,të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të për mbushen nga personat,operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerë te punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen,në aktivitete te prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla" AK-ne këtë aktivitet e ka respektuar LPP-ne dhe nenin konkret te theksuar nga OE,Ankues.

Përgjigjeje ne pretendimin ankimore se është shkelur nenin 6 i LPP-së

Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Edhe këto nuk qëndrojë sepse ky Nen thekson "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit".ne këtë rast AK-ka shpallur këtë procedurë duke siguruar edhe mjete qe e ka te përcaktuar ne vlerën e parashikuar për këtë aktivitet prokurimi.

Përgjigjeje ne pretendimin ankimor për shkeljet e Neni 7

Barazia në Trajtim / *Jo*-Diskriminimi,Këto pretendime nuk qëndrojnë sepse ne paragrafin 1 të këtij neni thuhet :"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente" AK,ne kete aktivitet e ka respektuar kete nen sepse aj ka shpallur proceduren prokurimi te hapur,qe eshte publikuar ne platformen e prokurimit elektoronik,te gjthe ofertuesit kane qasje mund te ofertojn i kane te percaktuara kriteret transparente ,publike ,jo diskriminuese.

Përgjigje në pretendimin ankimor per shkeljet e Nenit 9.

Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur AK-ne këtë aktivitete e ka plotësuar respektuar edhe këtë nen te LPP-se ku ne këtë nen thuhet "Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit,ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues.
AK- I Ka plotësuar ato dokumentacionet qe kërkohen për fillimin dhe zhvillimin e nje procedure te prokurimit prandaj pretendimet ankimore te OE-se ankuese nuk qëndrojnë

Përgjigje në pretendimin ankimor për shkeljet e nenin 16.

Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Furnizim, Lidhur me këtë, ky pretendim ankimor nuk qëndron sepse AK-ka llogaritur vlerën e parashikuar ne Njoftimin për Kontratë,duke u bazuar ne kontratat e

kaluara bile e ka rritur vlerën e parashikuar për ketë aktivitet prokurimi. Përgjigjeje ne pretendimin ankimor për shkeljet e Neni56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien Kontratave, Lidhur me këtë AK e ka respektuar ketë dispozitë te nenin te lartcekur sepse ne Njoftimin për Kontratë dhe ne dosjen e tenderit i ka përcaktuar dispozitat e përgjithshme me përzgjedhjen e pjesëmarrëseve,ofertuesve sepse ne ketë nen thuhet citoj;Të gjitha kontratat publike do të jepen,sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë,dhe përmes: Së pari,vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51të këtij ligji,dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28të këtij ligji; 1.2 së dyti,vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin të këtij ligji.

Përgjigjeje ne pretendimin ankimor lidhure me shkeljet e nenin 60 te LPP-se Neni60 Kriteret për Dhënien e Kontratës,Edhe këto pretendime nuk qëndrojnë sepse AK e ka respektuar këtë nen te LPP-se ku thuhet: Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52tekëtij ligji. Te nderuar lidhur me piken e ankeses te OE,se ankuese tek Deklarata detale mbi faktet edhe argumentet tek pershkrimi i rrethanave ,ku pika kryesore e ankimimit qendoren ne at se kinse AK-Nuk ka siguriar buxhet te mjaftueshme per kete aktivitet prokurimi ,Pretendimet ankimore te OE-së ankuese nuk qendrojn sepse AK- e ka shpallur proceduren me buxhet me te vogel mirepo nderkoh AK-ja e ka rritur buxhetin per kete Aktivitet prokurimi me Formularin Standard per Korigjimet e Gabimeve ne Njoftimet e Publikuara ku buxheti i planifikuar nga shuma prej 895.000.00 € eshte rrituer ne shumen prej 995.000.00 €, pra buxheti per kete aktivitet eshte rritur per 100,000.00 €uro me shumë.

Se ankesa eshte e papabuzar eshte edhe fakti se i njejti operator ekonomik **"GRAMI"SHPK** ne nje Procedure te Negociua pa Publikim te Njoftimit per Kontrate qe e ka zhvilluar AK-Konkrete (KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a),ku nga buxheti i ndar per kete aktivitet qe ishte ne shume totale prej 124,202.00 €uro Operatori ankues ne ketë lloji të procedures ,ka ofertuar me çmim per tone /njesi në vlerë prej 103.84 €uro apo totali i kontrates ishte ne shume prej 110,070,40 € qe kuptohet se edhe me kete çmim per ton , Operatori ekonomik ne fjale ka dhen oferten e tij,ku ne kete rast limitin per te oferuar nje çmim me te lart e kishte OE,ankues,ky fakt flete se OE,ankues ka llogari ,apo leverdi ekonomike te oferton me çmimin e planikuar ne proceduren aktuale mirepo pabazë po insiston qe te rritet planifikimi.

Se ankesa eshte e pabazë fletë edhe ajo se OE,ankues me AK- KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A. ne proceduren e negociuar e ka oferuar kete çmim kurse pse tash ne procedur te hapur

kerkon te rritet vlera e planifikuar per kete aktivitet,kur procedura eshte e hapur dhe OE,Ankues mund te hyn ne konkurence me ofertues tjerë, po ashtu edhe fakti qe thekson OE-Ankues se kinseeshte koha e pandemis Covid 19 dhe duhet rritur vlera e planifikaur prap nuk qendorojn sepse edhe Procedura e Negociauar Pa Publikim te Njoftimit per Kontratë eshte zhvilluar ne kohe pandemie konkretisht procedura e kaluar ne fjal eshte zhvilluar gjate muajit Tetor te keti viti , dhe kontrata eshte lidhur me dt.23,10,2020. OE,ankues meqense eshte procedur e hapur mund te dorëzon ofertë me buxhetin aktual te planifikuar sepse buxheti i planifikuar per kete aktivitet eshte i mjaftueshme. Pretendimet aknimore mendoj se jane te papazuara prandaj AK-Duhet te vazhdoj me kete procedurë.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa të hedhet si e pabazuar, dhe Njoftimi për Kontratë i AK- të vërtetohet dhe AK të Vazhdon me hapa të tjerë për këtë procedurë.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 06.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 09.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, "GRAMI "SH.P.K-Prishtinë, me datë : 09.11.2020, me anë të parashtresës, kanë njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Per:OSHP - PSHAP: Furnizim me gëlqere te hidratizuar KEK 20 4358 111,Lënda: 845/2020. Përgjigje ne mendimin e ekspertit shqyrtues. Data: 10.11.2020 Nuk pajtohemi me Mendimin e Ekspertit Shqyrtues se "Ankesa duhet te hudhet si e pabazuar dhe Njoftimi për Kontrate i AK te vërtetohet dhe AK te vazhdon me hapa tjerë për këtë AP".

Eksperti shqyrtues ne këtë rast është bazuar vetëm ne sqarimet-përgjigjet e AK ne pretendimet e OE duke mos marre parasysh fare pretendimet e bazuara te OE se nuk është siguruar buxhet I mjaftueshëm për këtë AP dhe se ekziston mundësia qe ky AP te anulohet ne mungese te buxhetit te pa mjaftueshme -sepse te gjitha ofertat do te tejkalojnë substancialisht buxhetin e paparapare siç ka ndodhure edhe me AP për Furnizim me Hidroksid Natriumi. Buxheti I parapare për këtë aktivitet prokurimi është ma i vogël se kontrata e fundit dhe kontratat tjera për çmimin për njësi (€/ton). Ka ndryshim te buxhetit - diskrepance ne mes te buxhetit te TC B dhe TC ABuxheti nuk është rritur ne krahasim me rritjen e çmimeve te këtij artikulli dhe çmimeve ne përgjithësi ne

tregun global. Sa i përket arsyetimit te AK se OE me rastin e Aktivitetit te Prokurimit me negocim, OE ka pranuar çmimin e kontratës te fundit edhe pse buxheti ka qene me i larte. E vërteta është se OE "Grami" sh.p.k është ftuar i vetmi ne negociata pasi qe me pare ka pas një kontrate kornize për Gëlqere te hidratizuar dhe ka qene me i përgatituri qe te ofertoj dhe furnizoj me urgjence pasi qe AK ka pas shume nevojë. Pas negocimit OE ka ofruar çmimin 117.70 (€/ton, me TVSH) e qe ka qene ne kuadër te buxhetit te parashikuar, duke arsyetuar çmimin e ofruar me ngritjen e te gjitha parametrave ne kalkulimin e çmimit. Me këtë rast AK ka arsyetuar se nuk ka kurrfarë mundësie ligjore të pranoj çmimin e ofruar dhe ka kërkuar qe te pranohet çmimi i kontratës pasi qe ne një forme është vazhdim i kontiuniteti te kontratës te mëparshëm dhe se OE dhe prodhuesi janë te njëjtë dhe te mos iu sjellin problem ligjore AK por edhe ndërprerje te prodhimit pasi qe gëlqerja është e domosdoshme për procesin teknologjik dhe nuk është sasi e madhe për furnitor. Nga AK me negociata te një pas njëshme me këmbëngulje është kërkuar qe te kemi mirëkuptim dhe përkohësisht (për një sasi te caktuar) ta pranojmë çmimin e kontratës.

Pas bisedave te vazhdueshme qe kemi pas me prodhuesin dhe për hire te bashkëpunimit shume vjeçar dhe arsyes te AK, OE ka pranuar qe sasinë prej 1000 tone te liferon me çmimin e kontratës te mëparshme. Prove: ofertat e OE për rastin " me negocim" dhe korospondencat mes AK dhe OE

Prandaj nuk mund te merret si baze arsyetimi i AK se OE ka pranuar çmimin e kontratës për këtë rast për ta arsyetuar buxhetin e pamjaftueshëm për shpalljen e tenderit për Kontrate Kornize.

Kërkojmë nga PSH i OSHP qe te pranoj Ankesën tone si te bazuar dhe lenden ta kthej ne rishqyrtim për te marre Vendim ne dispozitiv. Mustafa Kavaja <Mustafa.Ka\aja@kek-energy.com>Wed, Oct 21, 2020 at 11:41 AM To: GRAMI Ltd <info@grami-ltd.com>

Cc: Flamur Bekteshi <Flamur.Bekteshi@kek-energy.com>, Muhamet Selmani <Muhamet.Selmani@kek-energy.com>, Ramadan Sokoli <Ramadan.Sokoli@kek-energy.com>, Abdylmexhid Pllana <Abdylmexhid.Pllana@kek-energy.com>

Përshëndetje, Për aktivitetin e prokurimit Furnizim me gëlqere te hidratuar dje kemi filluar negociatat dhe vlerësimin e juaj. Siç kemi diskutuara gjate negociatave kërkesa e komisionit vlerësues ka qene qe te jepni zbritje ne ofertën e juaj financiarë duke u bazuar ne kërkesën tone gjatë negociatave.

Presim urgjentisht përgjigjën e juaj. Me respekt, Mustafa Kavaja KEK-Zyrja Ekzekutive e Prokurimit / KEK- Executive Office of Procurement rr. Nëna Terezë nr. 36 – Toskana 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

tel / + 381 38 501 401 1240. GRAMI Ltd <info@grami-ltd.com> VVed, Oct 21,2020 at 3:52 PM

To: Mustafa Kavaja <Mustafa.Kavaja@kek-energy.com> Cc: Flamur Bekteshi <Flamur.Bekteshi@kek-energy.com>, Muhamet Selmani <Muhamet.Selmani@kek-energy.com>, Ramadan Sokoli <Ramadan.Sokoli@kek-energy.com>, Abdylmexhid Pllana <Abdylmexhid.Pllana@kek-energy.com>

Përshëndetje, Duke pasur parasysh kërkesën tuaj për furnizim emergjent, ne sot kemi kontaktuar prapë prodhuesin dhe transportuesin qe te kenë mirëkuptim për situatën dhe te na bëjnë një zbritje ne krahasim me ofertën e pare. Tani te bashkangjitur, po ju dërgojmë ofertën e re financiare për furnizim me gëlqere te hidratizuar. Kushtet tjera mbesin si ne ofertën e datës 20.10.2020.Me respekt.

PJESA II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Numri rendor	Pershkrimi	Nj-mat.	Sasia	Çmimi për njesi pa	Vlera pa TVSH	TVSH 18%	Totali me TVSH
1.	FURNIZIM ME GELQERE TË HIDRATIZUAR	ton	1060	99.75	105,735	19,032.30	124,767.30
Vlera totale me TVSH					124,767.30		

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI i OE: (shëno emrin e OE ose te konzorciumit):	GRAMISHPK vQA
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të E:	GRAMOZYMERI /'j
NËNSHKRIMI:	
Vendi dhe data:	PRISHTINE 21.10.2020
Vula e operatorit ekonomik / konzorciumit:	/

Faleminderit për përgjigjën e juaj.

Kërkojmë nga Ju që ofertën e juaj financiare të e rishikoni edhe njëherë dhe te ofroni vlere e një toni sipas kontratës kornize që ju e ke ekzekutuar deri me tani e që ka përfunduar.

Përgjigjën e juaj e mirëpresim deri ne ora 10:00 AM.

Me respekt,

Mustafa Kavaja KEK-Zyrja Ekzekutive e Prokurimit / KEK- Executive Office of Procurement
rr. NënaTerezë nr. 36-Toskana 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës tel / +381 38 5014011240
Email: mustafa.kavaja@kek-energy.com.Përshëndetje te nderuar,

Ju lutemi keni parasysh se çmimi i prodhuesit si dhe ai i transportit kane pasur ngritje për shkak te situatës me pandeminëcovid 19, dhe pas përfundimit - ndërprerjes se kontratës kornize qe kemi pasur kane ndërruare gjitha kushtet. Oferta e rikalukuar qe ju kemi dërguar dje e datës 21.10.20, është oferta me e mire e mundshme dhe është e pa negociushme. Arsye qe ju kemi bere zbritje ne krahasim me çmimin e pare, është duke pasur ne konsiderate nevojën emergjente te KEK-ut për furnizim me gëlqere. Çmimi mbetet ai i datës 21.10.2020.Çdo te mire

Mustafa.Kavaja@kek-energy.com> Thu, Oct 22, 2020 at 12:53 PM To: GRAMI Ltd <info@grami-ltd.com>

Cc: Flamur Bekteshi <Flamur.Bekteshi@kek-energy.com>, Muhamet Selmani <Muhamet.Selmani@kek-energy.com>, Ramadan Sokoli <Ramadan.Sokoli@kek-energy.com>, Abdylmexhid Pllana <Abdylmexhid.Pllana@kek-energy.com>

Përshëndetje, Edhe përkundër përpjekjeve te Autoritetit Kontraktues gjegjësisht komisionit te vlerësimit / negocimit për te kontraktuar gëlqere me çmimin e kontratës kornize te skaduar, Ju keni ofruar një çmim që nuk mundemi te e pranojmë, prandaj ju njoftojmë se oferta e juaj refuzohet. Me respekt,

Mustafa Kavaja KEK-Zyrja Ekzekutive e Prokurimit / KEK- Executive Office of Procurement

rr. Nëna Terezë nr. 36 – Toskana 10000 Prishtinë, Republika e Kosovëstel / + 381 38 501 401 1240 Email: mustafa.kavaja@kek-energy.com

From: GRAMI Ltd <info@grami-ltd.com> **Sent:** Thursday, October 22, 2020 9:07 AM

To: Mustafa Kavaja <Mustafa.Kavaja@kek-energy.com> Cc: Abdylmexhid Pllana <Abdylmexhid.Pllana@kek-energy.com>; Flamur Bekteshi Flamur.Bekteshi@kek- energy.com>; Muhamet Selmani <Muhamet.Selmani@kek-energy.com>; Ramadan Sokoli <Ramadan.Sokoli@kek-energy.com>

Subject: Re: 353 Furnizim me gëlqere te hidratuar

Përshëndetje te nderuar, Ju lutemi keni parasysh se çmimi i prodhuesit si dhe ai i transportit kane pasur ngritje për shkak te situatës me pandeminë covid 19, dhe pas përfundimit - ndërprerjes se kontratës kornize qe kemi pasur kane ndërruare gjitha kushtet. Oferta e rikalukuar qe ju kemi dërguar dje e datës 21.10.20, është oferta me e mire e mundshme dhe është e pa negociushme.

GRAMI Ltd <info@grami-ltd.com>Thu, Oct 22, 2020 at 1:17 PM To: Mustafa Kavaja <Mustafa.Kavaja@kek-energy.com> Cc: Flamur Bekteshi <Flamur.Bekteshi@kek-energy.com>, Muhamet Selmani <Muhamet.Selmani@kek-energy.com>, Ramadan Sokoli <Ramadan.Sokoli@kek-energy.com>, Abdylmexhid Pllana <Abdylmexhid.Pllana@kek-energy.com>

Përshëndetje të nderuar, Duke pasur parasysh se gëlqerja është esenciale për ju si AK, ne pranojmë te ulim çmimin sipas kontratës kornize te kaluar, por me kusht qe ju si AK ti anuloni panelit për neve si OE për furnizimet e mëparshme te kontratës se kaluar 1606 sepse plani i furnizimit ka qene ne koordinim me menaxheret e kontratës.

Kur te na njoftoni për heqjen e penaltive, do te ju dërgojmë çmimin e ri. Presim përgjigje nga ana juaj.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron;

Lidhur me pretendimin ankimor të operatorit ekonomik ankuese se AK ka shkelur nenin 1, qëllimin e LPP-së përkunder ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues sqaron se shkeljet e supozuara ndaj AK-së në këtë rast, janë pjesrisht të qëndrushme duke pas parasysh se me nenin 1 të LPP-së, theksohet se :"*Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase,më transparent edhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen,procedurat që do të ndiqen,të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të për mbushen nga personat,operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerë te punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen,në aktivitete te prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla*" sepse bazuar në sqarimet e ofruara nga OE ankuese, lidhur me çmimet e berzes dhe e-mailat me anë të cilave është zhvilluar komunikim mes OE ankuese dhe përfaqsusve të AK për aktivitetin e ngjajshëm me procedurë të negociuar, konstatohet se në këtë rast AK-ka shpallur këtë procedurë duke mos u siguruar se ka parashikuar mjete të mjaftushme me të cilat do ti respektonte të drejtat dhe detyrimet që duhet të përmbushen nga autoritetet kontraktuese për ta realizuar këtë aktivitet të prokurimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të operatorit ekonomik ankuese se AK ka shkelur nenin 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti te LPP-së përkunder ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues sqaron se shkeljet e supozuara ndaj AK-së në këtë rast, janë pjesrisht të qëndrushme duke pas parasysh se me nenin 6 të LPP-së, theksohet se:"*Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit*", sepse bazuar në sqarimet e ofruara nga OE ankuese, lidhur me çmimet e berzes dhe e-mailat me anë të cilave është zhvilluar komunikim mes OE ankuese dhe përfaqsusve të AK për aktivitetin e

ngjajshëm me procedurë të negociuar, konstatohet se në këtë rast AK-ka shpallur këtë procedurë duke mos u siguruar se ka parashikuar mjete të mjaftushme për ta realizuar këtë aktivitet të prokurimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të operatorit ekonomik ankuese se, AK ka shkelur nenin 7, Barazia në Trajtim / *Jo*-Diskriminimi te LPP-së, konform ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues sqaron se shkeljet e supozuara ndaj AK-së në këtë rast, nuk janë të qëndrushme duke pas parasysh se me paragrafin 1 te nenin 7 të LPP-së, theksohet se: *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"* AK, në këtë aktivitet e ka respektuar këtë nenë sepse, ka shpallur proceduren prokurimi të hapur, të cilen e ka publikuar në platformen E-prokurimit, ku mund të kenë qasje të gjthë operatoret ekonomik të interesuar, si dhe operatori ekonomik ankues këtë nenë vetëm e ka përmendur sipërfaqsisht pa ofruar ndonjë fakt konkret për mos trajtim të barabartë apo diskriminues ndaj ndonjë operatori ekonomik.

Lidhur me pretendimin ankimor të operatorit ekonomik ankuese se AK ka shkelur nenin 9, Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur, te LPP-së përkunder ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues sqaron se shkeljet e supozuara ndaj AK-së në këtë rast, janë pjesrisht të qëndrushme duke pas parasysh se me nenin 9 të LPP-së, theksohet se: *"Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit,ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues"*, përkunder që AK- i ka plotësuar dokumentacionet që kërkohen për fillimin dhe zhvillimin e nje procedure te prokurimit, bazuar në sqarimet e ofruara nga OE ankuese, lidhur me çmimet e berzes dhe e-mailat me anë të cilave është zhvilluar komunikim mes OE ankuese dhe përfaqsusve të AK për aktivitetin e ngjajshëm me procedurë të negociuar, konstatohet se në këtë rast AK-ka shpallur këtë procedurë duke mos u siguruar se ka bërë vlerësimin e nevojshëm lidhur me parashikimin e mjeteve të mjaftushme për ta realizuar këtë aktivitet të prokurimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të operatorit ekonomik ankuese se AK ka shkelur nenin 16, Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Furnizim, te LPP-së përkunder ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues sqaron se shkeljet e supozuara ndaj AK-së në këtë rast, janë pjesrisht të qëndrushme përkunder që AK ka llogaritur vlerën e parashikuar në Njoftimin për Kontratë, duke u bazuar në kontratat e kaluara bile e ka rritur vlerën e parashikuar për ketë aktivitet prokurimi, mirëpo bazuar në sqarimet e ofruara nga OE ankuese, lidhur me çmimet e berzes dhe e-mailat me anë të cilave është zhvilluar komunikim mes OE ankuese dhe përfaqsusve të AK për aktivitetin e ngjajshëm me procedurë të negociuar, konstatohet se në këtë rast AK-ka

shpallur këtë procedurë duke mos u siguruar se ka bërë llogaritjen e vlerës se nevojshëm lidhur me parashikimin e mjeteve të mjaftushme për ta realizuar këtë aktivitet të prokurimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të operatorit ekonomik ankuese se AK ka shkelur nenin 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien Kontratave, te LPP-së konform ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues sqaron se shkeljet e supozuara ndaj AK-së në këtë rast, nuk janë të qëndrushme, duke pas parasysh se me nenin 56 të LPP-së, theksohet se;*Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë,dhe përmes: Së pari,vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51të këtij ligji,dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji; 1.2 së dyti,vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji"*, si dhe operatori ekonomik ankues këtë nenë vetëm e ka përmendur sipërfaqsisht pa ofruar ndonjë fakt konkret lidhur me shkeljen e dispozitave të përgjithshme.

Lidhur me pretendimin ankimor të operatorit ekonomik ankuese se AK ka shkelur nenin 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, te LPP-së, konform ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues sqaron se shkeljet e supozuara ndaj AK-së në këtë rast, nuk janë të qëndrushme, duke pas parasysh se me nenin 60 të LPP-së, theksohet se: *Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52tekëtij ligji"*, si dhe operatori ekonomik ankues këtë nenë vetëm e ka përmendur sipërfaqsisht pa ofruar ndonjë fakt konkret lidhur me shkeljen e kritereve për dhënje të kontrates.

Perkunder konstatimeve te ekspertit shqyrtues: *Te nderuar lidhur me piken e ankeses te OE,se ankuese tek Deklarata detale mbi faktet edhe argumentet tek pershkrimi i rrethanave , ku pika kryesore e ankimimit qendoren ne at se kinse AK-Nuk ka siguriar buxhet te mjaftueshme per kete aktivitet prokurimi ,Pretendimet ankimore te OE-së ankuese nuk qendrojn sepse AK- e ka shpallur proceduren me buxhet me te vogel mirepo nderkoh AK-ja e ka rritur buxhetin per kete Aktivitet prokurimi me Formularin Standard per Korigjimet e Gabimeve ne Njoftimet e Publikuara ku buxheti i planifikuar nga shuma prej 895.000.00 € eshte rrituer ne shumen prej 995.000.00 €, pra buxheti per kete aktivitet eshte rritur per 100,000.00 €uro me shumë.*
Se ankesa eshte e papabuzar eshte edhe fakti se i njejti operator ekonomik ***"GRAMI"SHPK*** *ne nje Procedure te Negociua pa Publikim te Njoftimit per Kontrate qe e ka zhvilluar AK-Konkrete (KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a),ku nga buxheti i ndar per kete aktivitet qe ishte ne shume totale prej 124,202.00 €uro Operatori ankues ne ketë lloji të procedures ,ka ofertuar me çmim per tone /njesi në vlerë*

prej 103.84 €uro apo totali i kontrates ishte ne shume prej 110,070,40 € qe kuptohet se edhe me kete çmim per ton, Operatori ekonomik ne fjale ka dhen oferten e tij, ku ne kete rast limitin per te oferuar nje çmim me te lart e kishte OE,ankues,ky fakt flete se OE,ankues ka llogari ,apo leverdi ekonomike te oferton me çmimin e planikuar ne proceduren aktuale mirepo pabazë po insiston qe te rritet planifikimi.

Se ankesa eshte e pabazë fletë edhe ajo se OE,ankues me AK- KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A. ne proceduren e negociuar e ka oferuar kete çmim kurse pse tash ne procedur te hapur kerkon te rritet vlera e planifikuar per kete aktivitet,kur procedura eshte e hapur dhe OE,Ankues mund te hyn ne konkurence me ofertues tjerë, po ashtu edhe fakti qe thekson OE-Ankues se kinse eshte koha e pandemis Covid 19 dhe duhet rritur vlera e planifikaur prap nuk qendorojn sepse edhe Procedura e Negociauar Pa Publikim te Njoftimit per Kontratë eshte zhvilluar ne kohe pandemie konkretisht procedura e kaluar ne fjal eshte zhvilluar gjate muajit Tetor te keti viti , dhe kontrata eshte lidhur me dt.23,10,2020. OE,ankues meqense eshte procedur e hapur mund te dorëzon ofertë me buxhetin aktual te planifikuar sepse buxheti i planifikuar per kete aktivitet eshte i mjaftueshme, përkunder ketyre konstatimeve të lartë cekura të ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues sqaron se këto konstatime dhe shkeljet e supozuara ndaj AK-së në këtë rast, janë pjesrisht të qëndrushme sepse bazuar në sqarimet e ofruara nga OE ankuese, lidhur me çmimet e berëzës dhe e-mailat me anë të cilave është zhvilluar komunikim mes OE ankuese dhe përfaqësuesve të AK për aktivitetin e ngjashëm me procedurë të negociuar, konstatohet se në këtë rast AK-ka shpallur këtë procedurë duke mos u siguruar se ka bërë llogaritjen e vlerës se nevojshëm lidhur me parashikimin e mjeteve të mjaftueshme për ta realizuar këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqaron se autoriteteti kontraktues është i obliguara që konform nenit 9 të LPP-së të sigurojnë vlersimin formal të gjitha elementeve rreth një aktiviteti të prokurimit përfshirë vlerësimin e vlerës së parashikuar për atë aktivitet të prokurimit duke marr në konsiderat në rastin konkret paragrafin 1 të nenit 16 ku potencohet se vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për furnizim duhet të jetë e barabartë me çmimin përfundimtar që duhet të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha produktet, shërbimet dhe objektet e tjera që përfshihen në një kontratë të tillë. Çmimi i parashikuar i produkteve, shërbimeve dhe objekteve është çmimi i parashikuar i tyre në ditën e dërgimit të njoftimit të kontratës lidhur me to. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për furnizim, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për produktet, shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, doganat dhe tarifat e tjera.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqaron se autoriteteti kontraktues është i obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht

duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli shqyrtues

Bujar BUJINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 /AK/ - "Korporata Energjetike e Kosovës"SH.A,

1x1 / OE/ -"Grami"SH.P.K-Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.